



RAPORT MONITORIMI
Maj-Korrik 2021

Mjeku i Ri



AUTOR
STIVEN SHALA

QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom Around the World

www.qeverisja.qq.com.al

MJEKU I RI NË KRIZË

Mjekësia e Përgjithshme vazhdon të mbetet një nga degët më të kërkuara për maturanët e çdo brezi, së bashku me inxhinieritë dhe informatikën. Në të njëjtën kohë, **Shqipëria ka numrin më të ulët të mjekëve në rajon me vetëm 1.2 mjek për 1000 banorë.** E me sa duket mungesa e personelit shëndetësor do të theksohet edhe më shumë në vitet e ardhshme duke qenë se gjithmonë e më pak studentë po vazhdojnë specializimin në Shqipëri. *Vitet e fundit vihet re që janë të paktë mjekët e rinj që zgjedhin të konkurojnë për specializim në Universitetin e Mjekësisë të Tiranës, duke zgjedhur të largohen drejt një vendi tjetër.*



Edhe këtë vit, kërkesa ishte më e ulët se oferta. Nga 285 kuota të miratuara, vetëm 236 mjekë të rinj zgjodhën të konkurojnë për një vend. E nga këto 236, 41 zgjodhën të tërhiqen ose të mos paraqiten në momentin e fundit.

Kjo situatë në fakt, ka vite që ndjehet, së pari nga vetë personeli shëndetësor, nga drejtuesit Universitetit të Mjekësisë apo nga bluzat e bardha në strukturat shëndetësore në vendin tonë. E përsëri ato që e vuajnë më tepër, janë qytetarët, sidomos në lokalitete më të vogla, ku qendrat shëndetësore e strukturat spitalore po vuajnë për mjekë specialistë, duke e detyruar qytetarin t'i drejtohet Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" ose spitaleve private në Tiranë.

Në këtë raport është analizuar situata me specializimet afatgjata në mjekësi për periudhën 2016-2021, me qëllim evidentimin e situatës dhe arsyeve pse mjekët e rinj nuk zgjedhin ta vazhdojnë formimin e mëtejshëm në vendin tonë.

Pas 6 viteve studime në degën "mjekësi e përgjithshme", një i sapodiplomuar ka **2 mundësi:** ose të nisë të punojë direkt aty ku gjen hapësirë ose të vazhdojë zhvillimin profesional duke zgjedhur një specializim të caktuar.

Në vendin tonë këtë vit u ofruan plot 29 programe studimi - lloje specializimesh - ku më të kërkuarat vazhdojnë të jenë kardiologjia, kirurgjia plastike dhe okulistika. E ndërkohë specializime si mjek urgjence apo mjek internist vazhdojnë të kenë shumë pak kërkesa.

Megjithatë, shumë shpejt, sistemi ynë shëndetësor nuk do të vuajë vetëm për mjek urgjence apo internist, por edhe për kardiolog dhe endokrinolog. Hendeku i madh kërkesëofertë i krijuar në specializimet afatgjata është problematikë e bartur, e në të njëjtën kohë kjo boshllëku i krijuar ndër vite për mjekë specialistë, nuk e ka marrë vëmendjen e duhur në asnjë moment nga qeveria.

Deri para disa viteve, kishte shumë aplikantë por nuk kishte kuota specializimesh të hapura e si rrjedhojë ishin të shumtë ato që u detyruan të

lëviznin jashtë për të ndjekur studimet. Sot, vendet hapen, po mjekë kemi pak, e edhe ato që i kemi zgjedhin të largohen.

Në listën përfundimtare të përzgjedhjes së degëve të specializimeve afatgjata në mjekësi **për vitin akademik 2020-2021 konstatohet se vetëm 70% e vendeve plotësohen. Ky 30% i mbetur bosh është qartazi një këmbanë alarmi për shoqërinë shqiptare.** Formimi i mjekëve të rinj që do sigurojnë shërbimin shëndetësor në të ardhmen është drejt shkatërrimit duke vënë në pikëpyetje të ardhmen e sistemit.

Për vitin akademik 2019-2020, kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, pra për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, **ishin në total 285.** Numri i aplikantëve ishte 276, ndërsa nga listat e vëna në dispozicion nga UMT, shihet se vetëm **185 studentë e kanë vazhduar rrugëtimin.**

Për vitin akademik 2018 -2019, kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, pra për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, **ishin në total 299.** Numri i aplikantëve ishte 323, ndërsa nga listat e vëna në dispozicion nga UMT, shihet se vetëm **217 studentë e kanë vazhduar rrugëtimin.**

Për vitin akademik 2017 – 2018, kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, pra për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, **ishin në total 247.** Numri i aplikantëve ishte 342, ndërsa nga listat e vëna në dispozicion nga UMT, **shihet se vetëm 210 studentë e kanë vazhduar rrugëtimin.**

Për vitin akademik 2016-2017, kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, pra për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, ishin në total 186. Numri i aplikantëve ishte 284, ndërsa nga listat e vëna në dispozicion nga UMT, **shihet se vetëm 162 studentë e kanë vazhduar rrugëtimin,** ndërsa 68 nuk paraqiten ose tërhiqen last minute.

Qartazi shikohet se si çdo vit, mjekët e rinj e refuzojnë atë çfarë Qendra Spitalore-Universitare Nënë Tereza i ofron.



Një mjek i ri e ka parë gjatë studimeve se si ilaçet mungojnë në spital, se si nuk mund të kryejë ekzaminimet e plota për pacientin ngaqë nuk ekzistojnë kushtet.

Një mjek i ri e ka parë se si bluzat e bardha përçmohen, si etiketohen si hajdutë e si madje dhe kërcënohen vazhdimisht, duke mos lënë pas arrestimet pa hetime të plota apo pa adresuar problematikën në thelb.

Një mjek i ri e ka parë se si funksionon karriera dhe ngritja në karrierë, me pozicionet drejtuese të uzurpuara pa meritokraci, pa garë reale, të blera apo të dhuruara nga partia në pushtet dhe si vazhdojnë e trashëgojnë brez pas brezi.

Një mjek i ri e ka parë se si është cilësia e formimit, si mungon kërkimi shkencor apo projektet me një impakt direkt në rritjen reale të kapaciteteve të stafeve tona shëndetësore.

Një mjek i ri e ka parë mësimdhënien 'cilësorë', shit-blerjen apo dhurimin e notës. E në fakt deri para disa vitesh, edhe kuotat e specializimeve shiteshin. Me mijëra euro ishte bakshishi për të fituar një vend specializimi 'të mirë' – okulistikë, kardiologji,

obsetrikë etj. Më vone, u vendos sistemi elektronik i provimit duke siguruar uljen e këtij fenomeni, edhe pse nuk e zhduku totalisht.

Sot jo vetëm që nuk japin më bakshish për një vend specializimi, por braktisja vetëm sa rritet çdo ditë, sikurse tregojnë shifrat që paraqiten në këte raport, duke e lënë vendin për një mundësi më të mirë zhvillimi në vendet e Evropës. Por edhe studentët që duan të vazhdojnë në Shqipëri, qoftë për dëshirë personale apo për mungesë mundësie për të lëvizur jashtë nga vendi, shumë tërhiqen ose refuzojnë të vijojnë studimet.



Në një intervistë për 'Panorama'¹, Rektori i Universitetit të Mjekësisë, prof. dr Arben Gjata, liston tre faktorët, të cilët kanë ndikuar në numrin e ulët të kërkesës. Sipas profesorit këta faktorë kanë në qendër pandeminë dhe duke qenë se shumë studentë nuk arritën të mbrojnë diplomat apo gjuhën e huaj ato nuk arritën të bëhen pjesë e konkursit. E megjithatë, sipas profesor Gjatës, problemi më i madh në këtë pikë, që kërkon adresim të menjëhershëm, është se një pjesë e mirë e të rinjve ndërrojnë mendje dhe refuzojnë të vijojnë studimet. Zgjidhjen, profesor Gjata, e shikon tek pagat më të larta.

Preferenca për disa specializime të caktuara si dhe nevoja për të ndjekur një specializim të mbuluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë gjithashtu dy arsye që i zbrapsin jo pak mjekët, të cilët preferojnë më mirë të presin edhe një vit, se sa të ndjekin specializimin që nuk i përshtatet apo të sakrifikojnë duke zgjedhur një kuotë të lirë.



Para se të nisin specializimin, mjekët firmosin një kontratë paraprake me Ministrinë ku përcaktohet punësimi i menjëhershëm në përfundim të tij. Ata janë të detyruar të zbatojnë kontratën për një afat kohor prej jo më pak se tri vitesh, pasi në të kundërt gjobiten.

Por nëqoftë se kandidati nuk arrin të sigurojë një kuotë të mbuluar nga Ministria përkatëse, atëherë ai ka mundësinë të zgjedhë një kuotë të lirë – term ky që nuk aplikohet në vendet e zhvilluara.

Në momentin që një kandidat zgjedh një kuotë të lirë, atëherë ky i ri duhet të paguajë një tarifë të konsiderueshme çdo vit dhe duke mos u paguar aspak pavarsisht se punon në mënyrë aktive. Ndarja në specializantë kuotë e lirë dhe specializantë kuotë e mbuluar është gabim. Nuk ekziston diku tjetër termi 'kuotë e lirë'.

Një mjek specializant nuk është student, ai është mjek në formim dhe si i tillë ai jep kontributin e tij direkt në spitalin ku specializohet, si pjesë aktive e shërbimit shëndetësor. Pozicioni 'mjek specializant' është pjesë e

¹ <http://www.panorama.com.al/specializimet-ne-krize-per-mjeke-me-shume-kuota-se-studente-arben-gjata-ja-profilet-me-te-preferuara-e-ato-ku-sistemi-ka-mangesi/>

organigramës së shërbimit universitar në çdo vend të përcaktimit dhe si fill të paguhet.

Perceptimi, Sfidat dhe Studentët e Mjekësisë.


Çdo problematikë fillon me sistemin arsimor, me formimin qoftë profesional apo akademik që një i ri merr në Universitetin e Mjekësisë.

Studentët e mjekësisë sot janë më të zhgënjyer se kurrë. Shifrat tregojnë se çdo vit Shqipërisë i largohen dhjetra specialistë. Dëshirën për largim, **Qëndresa Qytetare e konstatoi edhe në një anketë të realizuar me 71 studentë të degës 'Mjekësi e Përgjithshme' në Universitetin e Mjekësisë Tiranë.**

Në studentët që morën pjesë në anketim, **vetëm 8.5% ishin të kënaqur me cilësinë e studimeve që po ndjekin.** Gjatë shkollimit 6 vjeçar, studenti i

A jeni të kënaqur me cilësinë e studimeve që po ndjekni?

71 responses




mjekësisë arrin ta kuptojë si është sistemi, sa ia vlen të vazhdojë investimin në vend dhe sa do vlerësohet nesër si pjesë e këtij sistemi.

Akoma më dëshpëruese është e dhëna për vazhdimin e studimeve në vendin tonë. Të pyetur mbi dëshirën për të vazhduar specializimin në Shqipëri, **vetëm 4% e studentëve shprehen pro,** ndërkohë 27% e studentëve janë të pavendosur.

A dëshironi ta zhvilloni specializimin në Shqipëri?

71 responses



Të pyetur mbi arsyet kryesore për të cilat studenti shqiptar nuk ka dëshirë ta zhvillojë specializimin në Shqipëri, studentët evidentojnë probleme të shumta. Fjala cilësi gjendet në çdonjërin nga përgjigjet – studentët shprehen se mungesa e cilësisë duhet parë në disa komponentë:



Kushtet e mësimdhënies

Mungesa e infrastrukturës duke nisur me ambientet spitalore dhe duke vazhduar me klasat/laboraret specifike



Mundësia e ulët për zhvillimin akademik e profesional, në pamundësi të financimit korrekt të projekteve studimore e kërkimit shkencor.




Mungesa e profesionalizmit nga udhërrëfyesit, largësia mjek primar–specializant si dhe mungesa e frymës së bashkëpunimit e mirëkuptimit



Cilësia e dobët e kurrikulave akademike, theksuar kjo nga mungesa e përditësimit

Situata duket disi më pozitive kur studentët pyeten për të ardhmen e tyre si mjekë në Shqipëri. **Pothuajse 50% e të anketuarve shprehen se nuk e kanë vendosur akoma nëse duan ta ushtrojnë profesionin në vend.** Kjo shifër duhet të jetë këmbanë për çdo person që është përgjegjës për gjendjen e rënduar të sistemit tonë shëndetësor. Sot është koha për ndryshim. Studentët, mjekët e rinj, e meritojnë një mundësi në vendin e tyre. Ky potencial kaq i madh e investim nga shteti shqiptar në të njëjtën kohë, nuk duhet të humbasë.

A e shikoni të ardhmen tuaj si mjek profesionist në Shqipëri?
71 responses



Po cilat janë arsyet kryesore për të cilat këto studentë do e konsideronin ushtrimin e profesionit në një vend tjetër? Kjo është pyetja që duhet të adresohet nga institucionet.


Shumë shpesh aludohet se mjekët po zgjedhin të largohen nga vendi ynë vetëm për arsye financiare. Sipas anketës, të ardhurat – pra financat – nuk janë arsyeja kryesore për të cilën një profesionist nuk do e zgjidhte Shqipërinë.

Në vend të parë, studentët e UMT, kanë zgjedhur zhvillimin akademik dhe profesional. Plot 74% e këtyre studentëve do zgjidhnin ta vazhdonin karrierën e tyre në një vend tjetër për këtë arsye, shifër kjo që tregon se sistemi ynë universitar-shëndetësor ka dështuar të përmbushë pritshmëritë e studentëve si dhe të ofrojë një formim cilësor qoftë akademik apo profesional.

Në vendin e dytë, me plot 56% të studentëve, vijnë kushtet më të mira të punës. Studentët e dijnë mjaft mirë gjendjen e sistemit tonë shëndetësor, duke qenë se ato e prekin vetë çdo ditë në praktikat e tyre profesionale pranë strukturave spitalore. Një student e sheh vetë si një profesionist vuan çdo ditë dhe nuk arrin ta shijojë atë çfarë për të cilën ka investuar, një të ardhme të qetë e të sigurt.

Cilat janë dy arsyet kryesore për të cilën ju do e konsideronit ushtrimin e profesionit në një vend tjetër?

71 responses




A mendojnë studentët se të jesh mjek në Shqipëri do të thotë të jesh i vlerësuar? 25% e të anketuarve mendojnë pozitivisht, ndërsa **65% e tyre mendojnë se mjeku nuk vlerësohet si duhet në Shqipëri**. Këto përshtypje

A mendoni se mjeku është një figurë e vlerësuar në Shqipëri?

71 responses

- Po
- Jo
- Nuk e di



studentët i kanë ndërtuar gjatë viteve të studimit si dhe praktikave profesionale, pasi çdo ditë ato shohin se si personeli shëndetësor përballet me fyerje, presion apo edhe dhunë.

Kosova.

E megjithatë, shumë afër me ne ndodhet një shembull i mirë, Kosova. Edhe pse në Kosovë, sistemi shëndetësor nuk është perfekt, të paktën atje arrijmë të gjejmë disa ndryshime.

Së pari, mjekët trajtohen goxha mirë nga ana financiare – një mjek në Kosovë merr rreth 1200 euro në muaj.

Së dyti, specialistët reagojnë. Në maj të këtij viti, 600 specialistë iu drejtuan Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës me kërkesën për paga të rregullta e duke kërcënuar me protesta nëse nuk realizohej e drejta e tyre. Edhe Kosova, ashtu si Shqipëria ka disa kuota me vetëfinancim. Si specialistë të cilët janë me vetëfinancim, ky grupim ka kërkuar që të jenë të barabartë me kolegët e tyre, sepse kontributi dhe puna nuk dallon nga kolegët e tjerë të cilët janë me paga të rregullta.

Në Shqipëri, fatkeqësisht, reagimi është minimal – për mos të thënë inekzistent – nga studentët apo edhe nga mjekët e rinj, të cilët duhet të ishin të parët që kërkojnë rroga të rregullta e të mira, siguri në punë dhe një të ardhme të qëndrueshme.

Nevoja për ndërhyrje.

Largimi masiv i bluzave të bardha dhe braktisja e specializimeve në mjekësi janë këmbanë alarmi. Mungesa e personelit shëndetësor të specializuar na kushton jetë. Situata sot është shqetësuese por duket se do bëhet më keq.

Kolapsi i sistemit tonë shëndetësor merr vëmendje mediatike shumë rrallë dhe i gjithë problemi mbyllet me 2-3 kronika nga disa media. Ndërsa për institucionet, me sa duket, ky fenomen nuk përbën një problematikë.

Si fillim, analiza duhet të fillojë në çdo departament, fakultet e strukturë universitare. Analiza duhet të vazhdojë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe atë të Arsimit si dy institucionet më të larta përgjegjëse për formimin akademik dhe profesional të studentëve. Fatkeqësisht, as Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë nuk e ka adresuar këtë problematikë.

Largimi i mjekëve dhe ndikimi në cilësi.

Qëndresa Qytetare iu drejtua Urdhrit me një kërkesë për informacion për të parë si qëndron mosha mesatare e mjekëve në Shqipëri.

Sipas regjistrimit kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, mosha mesatare e mjekëve të regjistruar në vendin tonë, është 45 vjeç. Ndërsa mosha mesatare e mjekëve specialistë është 50 vjeç.

Të shumta janë strukturat shëndetësore duke nisur me qendrat shëndetësore e duke vazhduar me spitalet bashkiake që kanë rrezikuar dhe po rrezikojnë të mbyllen si pasojë e mungesës së mjekëve specialist. Më së shumti, këtë problematikë e vuajnë spitalet rajonale por edhe QSUT.

Rasti më i fundit që u bë publik në media ishte rasti i Dibrës, ku 200 gra paralajmëruan protestë duke qenë se materniteti i Spitalit Bashkiak Mat kishte një muaj pa shërbimin obstetër gjinekologjik.

Duke llogaritur periudhën kohore që merr që një specializant të përgatitet profesionalisht e që mesatarja është 10 vite, atëherë kuptohet që vendi mund të shkoj në një kolaps si pasojë e mungesës së specialistëve.

Por as profesionistët, intelektualët apo shoqëria civile nuk janë bërë pjesë e këtij debati. Edhe pse problemi pranohet gjerësisht, nuk arrihet të nisët një debat për të mirën e sistemin tonë shëndetësor si një e mirë publike në tërësi. Problematika duhet mbajtur gjallë me shpresën që të kthehet vëmendja e merituar për këtë problem që në të ardhmen do na kushtojë jetë njerëzish, ashtu sic na kushtoi mungesa e përgatitjes në rrethanat e pandemisë.

Po nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë, Qëndresa Qytetare mori informacionin për kërkesat e mjekëve për dokumente për punësim jashtë Shqipërisë.

Gjatë vitit 2019, 166 mjekë kanë kërkuar çertifikatën e sjelljes së mirë. Në vitin 2020, 132 mjekë kanë kërkuar çertifikatën e sjelljes së mirë si dhe deri tani, për vitin 2021, çertifikatën e sjelljes së mirë e kanë kërkuar 64 mjekë.

Ky trend i largimit të personelit shëndetësor ngelet shumë i madh dhe e vetmja rrugë për ta ndalur është nisja e një debati publik, me analiza konkrete duke përfshirë të gjithë palët e interesuara për të adresuar çdo shqetësim të personelit shëndetësor.

Sistemi shëndetësor është një e mirë publike, një pasuri kombëtare dhe si i tillë meriton një vëmendje të shtuar, sidomos në kushtet në të cilat gjendet. Pandemia na tregoi se si sistemin ynë shëndetësor është i brishtë, me mungesa në infrastrukturë e në personel të specializuar. Edhe pse situata epidemiologjike në vend sot është më mirë, Shqipëria nuk mund të rrezikojë të vazhdojë të gjendet e papërgatitur për kriza të tilla shëndetësore. Për më tepër, garantimi i shërbimit shëndetësor, për çdo qytetar, pavarisht a jeton në Tiranë apo në fshatrat me të thella, është detyrë e shtetit.

Shërbimi shëndetësor nuk duhet të mungojë për asnjë arsye, e sidomos kur arsyeja është mungesa e personelit atëherë faji bie direkt mbi drejtuesit e shëndetësisë të të gjitha viteve, të cilët me qëllim, apo jo, e kanë shkatërruar të ardhmen e shëndetësisë në vend.

GJETJET KRYESORE



Gjithmonë e më të paktë në numër janë mjekët e rinj që zgjedhin të konkurojnë për specializim në Universitetin e Mjekësisë të Tiranës; nga 285 kuota të miratuara, vetëm 236 mjekë të rinj zgjedhën të konkurojnë për një vend. E nga këto 236, 41 zgjedhën të tërhiqen ose të mos paraqiten në momentin e fundit.



Në anketën e realizuar me studentë të Universitetit të Mjekësisë, vetëm 8.5% ishin të kënaqur me cilësinë e studimeve që po ndjekin si dhe vetëm 4% e studentëve shprehin dëshirën për të vazhduar specializmin në Shqipëri.



Të pyetur për të ardhmen e tyre si mjekë në Shqipëri, pothuajse 50% e studentëve të anketuar shprehën se nuk e kanë vendosur akoma nëse duan ta ushtrojnë profesionin në vend.



74% e këtyre studentëve do zgjidhnin ta vazhdonin karrierën e tyre në një vend tjetër për zhvillim të mëtejshëm akademik dhe profesional. 56% e studentëve do zgjidhnin të largoheshin për kushte më të mira të punës.



Të pyetur për vlerësimin që pozicioni i mjekut ka në Shqipëri, 65% e studentëve mendojnë se mjeku nuk vlerësohet si duhet.



Mosha mesatare e mjekëve në Shqipëri është 45 vjeç. Ndërsa mosha mesatare e mjekëve specialistë është 50 vjeç.



Nga viti 2019 deri tani, 262 mjekë kanë kërkuar çertifikatën e sjelljes së mirë nga Urdhri i Mjekut, dokument ky që nevojitet për t'u bërë pjesë e sistemit shëndetësor të një vendi tjetër.

REKOMANDIMET

Ndrhyrja e menjëhershme në sistemin shëndetësor, duke e vlerësuar këtë sistemi si një e mirë publike e përbashkët, për t'i shëruar plagët disa-vjeçare me qëllim ndalimin e shkatërrimit të mëtejshëm.

Duke qenë se largimi i personelit shëndetësor vjen si pasojë e një kompleksiteti faktorësh, duhet të nisët një debat publik, me analiza konkrete duke përfshirë të gjithë palët e interesuara për të adresuar çdo shqetësim të personelit shëndetësor.

Të hiqet praktika e kuotave të lira. Specializantët duhet të paguhën të gjithë njësoj, pasi ato janë pjesë aktive e trajtimit shëndetësor të pacientëve dhe si të tillë, jo vetëm që nuk duhet të paguajnë, por të paguhën.

Nxitja e mjekëve të rinj për të ndjekur specializimin në Shqipëri qoftë me lehtësira apo edhe me motivim financiar.

Përmirësimi i kushteve qoftë për mjekun specialist apo edhe për studentët e mjekësisë, duke nisur me infrastrukturën e strukturave shëndetësore, apo edhe me kërkimin shkencor e projektet me impakt real në formimin e mëtejshëm.

Mbështetja ndaj mjekut specialist (primar) në mënyrë që ky mjek të shërbejë si udhërrëfyes për mjekët e rinj që ndjekin specializimin, duke shkurtuar distancën mjek primar – specializantë.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE